



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-346888

Datë: 15.04.2024

P r i z r e n

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit, duke vendosur sipas kërkesës së Gjeladin Shala nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar ndryshimin e projektit për objektin i cili është duk u ndërtuar në ngastrën kadastrale P-71813041-00988-211-ZK-Prizren, konform dispozitave të nenit 85 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 26 paragrafi 1 lidhur me nenin 27, 44, 45, 46, 47, 48 dhe nenin 89, si dhe neni 125 dhe 127 të LPPA-së, konform dispozitave të nenit 3, paragrafi 1 pika 1.1, 1.6, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.2, nënpika 1.2.2 dhe nenit 16 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Nr. 04/L-174, të datës 31 korrik 2013, po ashtu duke u bazuar në nenin 21 paragrafi 4 i të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, të datës 31.05.2012, si dhe konform Vendimit për Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022-2030, Nr. 001/011-48192, të datës 31.03.2022, bie këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet kërkesa e Gjeladin Shala nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar ndryshimin e projektit për objektin i cili është duk u ndërtuar në ngastrën kadastrale P-71813041-00988-211-ZK-Prizren **si e pa bazuar**.

A r s y e t i m

Parashtruesi i kërkesës Gjeladin Shala nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar ndryshimin e projektit për objektin i cili është duk u ndërtuar në ngastrën kadastrale P-71813041-00988-211-ZK-Prizren.

Në bazë të dokumentacionit i cili gjendet në shkresa të lëndës, si dhe shqyrtimit të saj nga ana e kësaj drejtorie, është lëshuar njoftimi për plotësimin e dokumentacionit me nr. 04-353/01-34688, të datës 25.03.2024, sipas të cilit njoftim është njoftuar pala që pranë shërbimit të DUPH-së në Prizren në afatin prej 8 ditësh ta kompletojë lëndën me dokumentacionin e kërkuar sikurse në njoftimin e lartcekur.

Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës e Gjeladin Shala nga Prizreni më datë 26.03.2024, ka pranuar njoftimin për plotësimin e dokumentacionit dhe që nga ajo datë e deri në nxjerrjen e këtij aktvendimi nuk ka prezantuar dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të datës 25.03.2024, me ç'rast edhe është njoftuar se brenda afatit të paraparë ligjor t'a kompletojë lëndën me dokumentacionin kërkuar. Po ashtu, në paragrafin e dytë të arsytimit të këtij njoftimi është cekur se procedurat në vazhdim e obligojnë palën ta prezantojë pranë shërbimit të DUPH-së dokumentacionin e kërkuar me qëllim të vazhdimit të procedurave, në të kundërtën kërkesa do të refuzohet. Andaj, pasi që pala pranë shërbimit të DUPH-së të njëjtat dokumente nuk i ka prezantuar, kjo nënkupton se nuk janë përmbushur kushtet për vazhdimin e hapave të më tutjeshëm ngase bie në kundërshtim me nenin 21, paragrafi paragrafi 4 i po këtij neni thotë se "pas pranimit të kërkesës së pakompletuar për leje ndërtimore për ndërtim të kategorisë I, organi kompetent brenda tetë (8) ditëve e njofton aplikuesin për hapat e nevojshëm që duhet t'i ndërmerr që ta kompletojë kërkesën. Pas pranimit të kërkesës së pakompletuar për leje ndërtimore për ndërtim të kategorisë II ose III, organi kompetent brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve e njofton aplikuesin për hapat e nevojshëm që duhet t'i

ndërmerr që ta kompletoj kërkesën. Nëse përmirësimet janë të nevojshme, aplikuesi i bën përmirësimet brenda tetë (8) ditëve për ndërtimet e kategorisë I dhe pesëmbëdhjetë (15) ditëve për ndërtimet e kategorisë II dhe III. Nëse aplikuesi nuk i përmbahet afateve pas njoftimit, organi kompetent mundet ta refuzoj kërkesën. Kjo kohë e shqyrtimit nuk do të ndikoj në afatin e organit kompetent për lëshimin e lejes sipas paragrafit 3. të këtij neni". Andaj, meqenëse parashtruesi i kërkesës nuk ka prezantuar pranë kësaj drejtorie dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor, drejtoria në fjalë vendosi sikurse në këtë aktvendim.


Andaj, konform të cekurave si në këtë aktvendim drejtoria në fjalë nuk mund të vendos në mënyrë pozitive lidhur me kërkesën e paraqitur për shkak të destinimit të përcaktuar për lokacionin në fjalë.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj drejtorie.

Bashkëpunëtore profesionale
Xhejlane Gjini-Ing.dipl.ark

Zyrtari i lartë Ligjor
Muhamed Kurtaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr : 04-353/01-34688
Më: 25.03.2024
P r i z r e n

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor- Komuna e Prizrenit duke vendosur sipas kërkesës Nr: 04-353/01-34688 me të cilën pala ka kërkuar leje për ndryshimin e projektit , duke vepruar konform dispozitave të nenit 69 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L031 datë.25.05.2016 e lidhur me dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.05/2017 lëshon këtë:

Njoftim për plotësim të dokumentacionit

Me qëllim të shqyrtimit të lëndës së parashtruar nga **Gjeladin Shala** me banim në rrugën ” / ” nr./ me të cilën ka kërkuar leje përndryshimin e projektit në ngastrat kadastrale P-71813041-00988-24 dhe P-71813041-00988-2 Z.K.Landovicë, pala njoftohet që pranë shërbimit të –DUPH-së në Prizren në afat prej 8 ditësh ta kompletoj lëndën me këtë dokumentacion përcjellës:

- Të prezantohet inqizimi i gjendjes faktike në teren.


ARSYETIM

Parashtruesi kërkesës, pranë shërbimit të DUPH-së në Prizren ka kërkuar leje për ndryshimin e projektit në ngastrat kadastrale P-71813041-00988-24 dhe P-71813041-00988-2 Z.K.Landovicë.

Andaj procedurat në vazhdim e obligon palën ta prezantoj pranë shërbimit të DUPH-së dokumentacionin e kërkuar ta sigurojnë me qëllim të vazhimit të procedurave, në të kundërtën kërkesa e juaj do të refuzohet.

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij Njoftimi pala e pakënaqur ka të drejtë kundërshtimi në afatin prej 30 ditësh, nga dita e marrjes MMPH-së në Prishtinë përmes kësaj Drejtorie.

Bashkëpunëtor profesional
Xhejlane Gjini, inxh.dipl.nd.



26.03.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

DATE:	03.05.2023
REFERENCE:	05-343-48670
PËR:	Z. Gjeladin Shala – Prizren
NGA:	Z. Çelë Lamaj, Drejtor i DSHP-së
TEMA	Pëlqim

Në bazë të nenit 17, të ligjit 03/L-040 për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe neni 20 të statutit të komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, dt. 15.10.2018 dhe nenit 44 të ligjit nr 05/L-031, për procedurën administrative dhe në bazë të udhëzimit administrativ nr. 02/2014. Në bazë të Ligjit mbi Rugët nr. 2003/11 me plotësim nr. 03/L-120 dhe Ligjit mbi Sigurinë e Komunikacionit Rrugor nr. 02/L-70 me plotësim nr. 05/L-088,
Dhe në bazë të kërkesës nr. 05-343-48670, të bërë nga ana z. Gjeladin Shala – Prizren
, duke u bazuar edhe në kërkesën për plotësim të dokumentacionit nga DUPH-ja, nr. 04-353/01-148382, dt. 09.12.2022, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike jep këtë:

P Ë L Q I M

Për kycjen e rrugës për nevojat e ndërtimit të **Objekt Ranch për kalërim me etazhitet P+0**, - Prizren, të ngastrës kadastrale 00988-24, 00988-2, zona kadastrale Landovicë.

I lejohet z. Gjeladin Shala – Prizren, kyçja ne rrugën rrugë sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, sipas kërkesës për kushtet ndërtimore kërkesës për plotësim të dokumentacionit nr. 04-353/01-148382, lëshuar nga DUPH-Prizren, pasi qe i plotëson kushtet e nevojshme për kyçje ne rrugë.

A r s y e t i m

Duke e shqyrtuar kërkesën e lartpërmendurit inspektorët e Komunikacionit kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë shikimin e terrenit në ngastrën ku është i ndërtuar objekti dhe pasi që parashtruesi i kërkesës ka bashkangjitur edhe dokumentacionin përkatës, është përpiluar edhe procesverbali nga ana e inspektorit dhe është konstatuar se:

Ekzekutuesi i plotëson standardet për kyçje në rrugë sipas rregullave të komunikacionit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Drejtoria e Shërbimeve Publike
Nr. 05-352-175723
Më : 19.01.2023



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 62 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Prizrenit, nenit 32 të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017, për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, Drejtoria e Shërbimeve Publike mori këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e **Gjeladin Shala**, me banim në Prizren për **Leje Mjedisore Komunale**, për projektin: **"Objekt-Ranch për kalërim", me etazhitet P+0, në Zk Landovicë-Prizren.**

Mënyra e realizimit është e përshkruar në vijim (Arsyetim) dhe është e obligueshme për palën

Arsyetim

Komisioni komunal për lëshimin e Lejeve Mjedisore Komunale e ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin, e dorëzuar nga Gjeladin Shala, me banim në Prizren, për Leje Mjedisore Komunale, për objektin – ranch për kalërim, në kuadër të parcelave kadastrale nr.00988-24 dhe 00988-2, evidentuar në certifikatat e njësive kadastrale P-71813041-00988-24 dhe P-71813041-00988-2, Zk Landovicë-Prizren dhe vlerëson si vijon:

Objekti dhe elementet tjera përcjellëse, të përshkruara në Raportin e Lejes Mjedisore Komunale (LMK-së), gjatë veprimit do të ndikojnë në ambient. Masat e përshkruara në Raport të Leje Mjedisore Komunale, do ta zvogëlojnë ndotjen dhe do t'i përmirësojnë objektivat, për mbrojtjen e mjedisit, andaj edhe plotësohen kushtet për Leje Mjedisore Komunale.

Leja Mjedisore Komunale është kusht për plotësimin e dokumentacionit teknik për ndërtim. Nëse nuk plotësohen kushtet e parapara në Raportin e LMK-së, Leja Mjedisore Komunale, do të anulohet.

Tarifa për lëshimin e kësaj leje Mjedisore Komunale është e paguar në lartësi prej 674.00 €, konform tarifave të përcaktuara në bazë të paragrafit 1.2 të nenit 10 të Rregullores 01/2019 për taksat, tarifat, ngarkesat dhe gjoba nga shërbimet komunale nr. 001/011-46063, të datës 28 mars 2019, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 001/011-105997, të datës 18 korrik 2019.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, aplikuesi, ka të drejtë ankese në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Drejtori i Shërbimeve Publike
Celë Lamaj

Vendimi iu dërgohet:

- 1.Parashtruesit të kërkesës
- 2.Komisionit për LMK
- 3.Inspektoriatit
- 4.Drejtorisë së Shërbimeve Publike
- 5.Arkivit të komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija Emergentnog Upravljanja/Emergency Management Agency

Agjencia e Menaxhimit Emergjent, në mbështetje të Nenit 12 dhe 13 të Ligjit për mbrojtje nga zjarri 04/L-012 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.7/10 gushtë 2011, Nenin 44 dhe 86. LPA,nr 05/L-031, duke vendosur sipas kërkesës së nr.0002230/2023

P Ë L Q I M

Gjeladin Shala nga Prizren i lëshohet pëlqimi në dokumentacionin teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri i cili ka të bëjë me ndërtimin e objektit Ranch per kalerim me etazhitet P+0, ku parashihet të ndërtohet me nr. parceles 00988-24, 00988-2, Certifikata kadastrale P- 71813041 Zona Katastrale Landovicë, Komuna e Prizrenit.

Invstitori është i obliguar që gjatë ndërtimit dhe funksionalizimit të këtij objekti të ndërmer të gjitha masat e parapara nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri sipas rregullave teknike në bazë të akteve ligjore.

A r s y e t i m

Gjeladin Shala nga Prizren i lëshohet pëlqimi në dokumentacionin teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri i cili ka të bëjë me ndërtimin e objektit Ranch per kalerim me etazhitet P+0, ku parashihet të ndërtohet me nr. parceles 00988-24, 00988-2, Certifikata kadastrale P- 71813041 Zona Katastrale Landovicë, Komuna e Prizrenit. Kërkesës pala i ka bashkangjitur, kushtet e ndërtimit,certifikatën e njësis kadastrave,kopjen e planit,projektin-elaboratin e mbrojtjes nga zjarri.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shikimin të dokumenteve, nga ana e komisonit është konstatuar se në dokumentacionin janë përfshir masat thelbësore për mbrojtje nga zjarri,investitori është i obliguar që gjatë ndërtimit dhe funksionalizimit të objektit të aplikoj të gjitha masat mbrojtëse nga zjarri sipas akteve ligjore,anda j komisioni ka propzuar për lëshimin e këti pëlqimi.

Nr.0002230/2023

Prizren 16.01.2023

Shefki Abdullahu

Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm te AME-së



	NJËSIA E SHËRBIMEVE ME KONSUMATORË	Nr.	KEDS-DCC-F-DCC-08
	FORMA E APROVIMIT TË PËLQIMIT PARIMOR	Faqe	Faqe 1 prej 2
		Versioni	1.0

Për: **Gjelajdin Muharem Shala**

Adresa: 70 Ismail Kryeziu

Lënda: 20[12]2022
Tiketa Nr.932778
PËRMES ARKIVËS

KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGIJE ELEKTRIKE SH.A.
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY I.S.C.
SLOVSKO PREDUZETE ZA DISTRIBUCIJU I SHABEDIANIE ELEKTRICNOH ENERGIJOM D.O.O.

KEDS - SH. A.

1036

21 DEC 2022

PRIZREN 6

DIVIZIONI I SHPËRNDARJES Distrikti
Prizren
Rr. Sylejman Rrotlla No 67
Prizren, 20000
Republika e Kosovës
www.keds-energy.com

PËLQIMI PARIMOR

Në bazë të kërkesës nr.932778 të datës 16.12.2022 nga ana e konsumatorit **Gjelajdin Shala**
Adresa: 7 Ismail Kryeziu, që ka të bëjë me dhënien e pëlqimit për rregullimin e dokumentacionit teknik në KK, për ndërtimin e objektit : **Ferma e kuajve me etazh.P+O,në ng.kat.988-2,24** jepet:

Pëlqimi për rregullim të dokumentacionit teknik.

Ky pëlqim i lëshohet palës për rregullimin e dokumentacionit teknik, ndërsa për nevoja të tjera nuk guxon të përdoret dhe nuk e kushtëzon Divizionin e Shpërndarjes për furnizim me energji elektrike para se kjo të rregullohet në **Pëlqim elektroenergetik**.

Po ashtu konsumatori obligohet që para fillimit të ndërtimit të objektit të aplikojë për kyçje të përkohshme.

Ky pëlqim vlen 60 ditë nga data e lëshimit, brenda këtij afati obligohet konsumatori ta sjell projektin e objektit për marrjen e pëlqimit energjetik.

Vërejtje: Ky dokument nuk i përcakton kushtet e kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes, kushtet e kyçjes do të përcaktohen me **Pëlqim Elektroenergetik**.

Nëse hasni në pengesa në infrastrukturën tonë, atëherë investitori duhet ta sanojë me shpenzime të veta.

Konsumatori obligohet ti largohet OEE aq sa kërkojnë normat dhe rregullat ne fuqi.

Nëse energjia elektrike do të përdoret për ngrohjen e objektit tuaj, jeni të obliguar të paraqitni fuqinë e angazhuar reale të objektit përmes projektit elektrik.

Në objektet banesore të gjithë njehsorët duhet të jenë të vendosur në një vend në përdhese, aty ku ka qasje të përhershme dhe pa pengesa për punëtorët e KEDS-it. Ormani me njehsorë nuk mund të instalohet në bodrum dhe vende të mbyllura dhe nëse duhet të ndërtoj TS duhet që ai të ndërtohet në vend të përshtatshëm (jo në bodrum) ku ekipet e KEDS-it mund të intervenojnë pa pengesa në çdo kohë dhe në çdo moment.

Nëse konsumatori do të jetë harxhues e energjisë reaktive, atëherë ai me çdo kusht do të instalojë me kohë kompensatorët, në mënyrë që të ruaj koeficientin e shfrytëzimit ≥ 0.95

Me respekt,

Inxhinieri në SHK

Ibrahim Spahiu

Inxhinieri i Rrjetit

Kodran Piraj

Drejtori i Distriktit

Shah Domuzeti

Ekzemplarë: 1x Palës,

1x Njesisë SHK,

1x Arkivit



Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.
"Wesley Clark", p.n. 20000 Prizren
Tel/Fax; 029/ 244-150 029/ 244-107
E-mail; sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

3594

23.12

2022

PRIZREN

DATË:	23.12.2022
REFERENCË:	Nr. Rastit: 63130, Datë: 22.12.2022
PËR:	Gjeladin Shala - Prizren
NGA:	Aranit Ukimeri, Menaxher Teknik
LËNDA:	Përgjigje në kërkesë, të datës: 22.12.2022, Nr. Rastit: 63130

Me datë: 22.12.2022, Nr.protokoli: 63130, KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren ka pranuar kërkesë nga Gjeladin Shala - Prizren, për pëlqim për kyçe në rrjetin e ujësjetës dhe të kanalizimit, për ngastrat kadastrale P-71813041-00988-2 dhe P-71813041-00988-24, Z. Kadastrale Landovicë.

Shërbimi teknik pas shqyrtimit të dokumenteve të bashkangjitura kërkesës në fjalë ka konstatuar që KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A nuk ofron shërbime të furnizimit me ujë dhe shërbime të sistemit të kanalizimit për ngastrën kadastrale për të cilën kërkohet pëlqim për kyçe në rrjetin e ujësjetës dhe të kanalizimit, pra nuk ka rrjet të sistemit të ujit dhe të kanalizimit.

Andaj, KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A në Prizren nuk mund të lëshojë pëlqim për zonat apo parcelat për të cilat nuk ofron shërbime të ujësjetës dhe shërbime të sistemit të kanalizimit apo nuk ka rrjet të sistemit të ujit dhe të kanalizimit.

KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A njofton palën e lartpërmendur për shfrytëzimin e ujërave nëntokësorë (puseve) përgjegjës është Kuvendi Komunal Prizren dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ky dokument lëshohet për rregullimin e dokumentacionit teknik të nevojshëm dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera.

Aranit UKIMERI
Menaxher Teknik
KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A



Telekomi i Kosovës – Departamenti Teknik

Data e lëshimit: 29.12.2022

Pëlqim Nr : 313/2022

Parashtruesi i kërkesës: Gjeladin Shala

Institucioni/firma:

Tema: Pëlqimi Parimor nga Telekomi i Kosovës

I,e nderuar ,

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, te Dt. 29.12.2022 , ku është kërkuar Pëlqim nga Telekomi i Kosovës për ndërtimin e objektit – Ranch per kalerim me etazhitet P+0 , ne parcelen me nr.P-71813041-00988-24 dhe P-71813041-00988-2 Zona Kadastrale Landovice, si në pikat e listuara më poshtë:

Nuk ka infrastruktur te Telekomit

Sipas urdhëresës sonë Nr 26/12 Dt 29.12.2022 për shikim të vend-punishtes, Telekomi i Kosovës – Departamenti Teknik, përkatësisht Njësia Regjionale Prizren lëshon këtë:

PELQIM PARIMOR

Kushtet e pëlqimit:


1. Parashtruesi i kërkesës zotohet që, tani dhe në të ardhmen, të mos paraqes kurrfarë pengesash në qasjen e Telekomit të Kosovës deri të konsumatorët potencial që gjinden në objektin që do të ndërtohet me këtë projekt.
2. Parashtruesi i kërkesës do të krijojë mundësi qasje për infrastrukturën e Telekomit të Kosovës, sipas UDHËZUESIT standard të bashkangjitur me këtë Pëlqim.

Menaxheri Regjional:

Përfaqësuesi i paraqitësit të kërkesës:

Arberie Skeraj

Emri dhe mbiemri


Nënshkrimi

Emri dhe mbiemri

data e pranimit

Nënshkrimi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRIZREN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Landovicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71813041-00988-2	Parcelë / Parcela / Parcel	3556



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 17.10.2022

Koha/ Vreme/ Time: 11:15:26

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-64740

Dt. 25.05.2023

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e **Gjeladin Shala** me banim në lagjen “Jeta e Re” nr.9/A, në bazë të nenit 3alineja 1 pikat 1.7 , 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alineja 1. Pika 1.1 nenin 15 alineja 1 pika 1.1 , neni 18 e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 ,si dhe konform neneve 14,15,16,17 dhe 18 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 , si dhe konform nenit 4 pika 6.1 ,paragrafi 2,dhe paragrafi 14 si dhe pika 6.3 e Rregullores për taksa,tarifa,ngarkesa dhe gjoba nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr.01/011-46063 dt.28.03.2019 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44,46,47,48 si dhe neneve 27dhe 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 me Nr. 001-011-48192, të datës 31.03.2022, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Gjeladin Shala		
Adresa:	Jeta e Re		
Telefoni:		Emaili:	

Emri i projektit	Objekti - Ranch për kalërim
Emri i projektuesit	Byro projektuese “MASTER PROJEKT” SH.P.K.
Adresa:	“ Ali Hadri” nr.13 Prizren



Telefoni:	+377 (0) 44/336-343 044/217-368 044/412-392	Emaili:	office.masterprojekt@gmail.com
-----------	---	---------	--------------------------------

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore **Gjeladin Shala** i lejohet ndërtimi i objektit- **Ranch për kalërim** në rrugën “ / ”nr. / . Zona Kadastrale Landovicë.

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa: ZK Petrovë		
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Landovicë Objekti - Ranch për kalërim do të ndërtohet në parcelën nr.P-71813041-00988-24 me sipërfaqe S=1888m ² dhe P-71813041-00988-2 me sipërfaqe S=3556m ² Z.K.Landovicë me dimensione sipas kopjes së planit. Sipërfaqe bruto e përdhësës është S=544.00m ² . Etazhiteti i objektit do të jetë P+0	GPS Koordinatat:

- Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej **2279.40€**
- Paralogjia e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **204,377.60 €.**

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtimi i ri ☒	Rindërtim ☐ Ripatim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria II ☐	
A përfshin kërkesa ndryshimin e destinimit? Po ☐ Jo ☒	
Përdorimi i propozuar i objektit – Afarist-depo	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Gjeladin Shala** i lejohet ndërtimi i objektit – **Ranch për kalërim me etazhitet P+0**.



Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuar nga Drejtoria e Inspektionit – inspektorati i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rast kur:
 - Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;

- Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.
 - Kunjëzimi i objektit, si dhe nivelizimi i themeleve të bëhet sipas kushteve ndërtimore si dhe dimensioneve të skicuara në kopjen e planit të lëshuar nga kjo Drejtori.
- P.S. Investitori është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte dhe është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK, KEDS-it, si dhe avari tjera ti evitojë dhe ti kthejë në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi
- Investitori është përgjegjës dhe obligohet që problemet eventuale që paraqiten në lidhje me rrugën të evitojë vetë.
- P.S. Ku Vendim konsiderohet i anuluar nëse investitori ndryshon destinimin e objektit.

A r s y e t i m

Aplikuesi **Gjeladin Shala** ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërtimore për **objektin – Ranch për kalërim**.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësim të dokumentacionit
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Pëlqimi nga “Ekoregjion”.
- Pëlqim nga Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë
- Leje Mjedisore Komunale
- Fletëpagesa e taksave për rregullimin e tokës ndërtimore
- Kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet MMPHI-së, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Bashkëpunëtor profesional:



Xhejlane Gjini, inxhi. dip. ark.

Drejtori:


Pranverim Berisha, jur.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRIZREN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Landovicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71813041-00988-2	Parcelë / Parcela / Parcel	3556



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 17.10.2022

Koha/ Vreme/ Time: 11:15:26

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRIZREN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Landovicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71813041-00988-24	Parcelë / Parcela / Parcel	1888



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 17.10.2022

Koha/ Vreme/ Time: 11:16:18

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoui/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-148382

Më: 09.12.2022

Prizren

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor - Komuna e Prizrenit duke vendosur sipas kërkesës së Gjeladin Shala me banim në Dushanovë në bazë të kërkesës për –Ndërtim të objektit – Shtallë e kuajve , duke vepruar konform dispozitave të nenit 27 dhe 69 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L031 datë 25. 05. 2016 e lidhur me nenin 3 pika 1.6 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dt. 31. 07. 2013 dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 – Nr. 001-011-48192 dt. 04. 04. 2022 lëshon:

Njoftim për plotësim të dokumentacionit


Me qëllim të shqyrtimit të lëndës së parashtruar nga ana e Gjeladin Shala me banim në rrugën “Jeta e Re” nr.9/A ,me të cilën ka kërkuar leje për ndërtimin e objektit –Ferma e kuajve me etazhitet P+0 në ngastrat katastrale numër **P-71813041-00988-24 dhe P-71813041-00988-2** Z. K. Landovicë me sipërfaqe të tërësishme prej **5444 m²**.

Pala njoftohet që pranë shërbimit të – DUPH-së në Prizren në afat prej Një (1) viti ta kompletoj lëndën me këtë dokumentacion përcjellës:

- Të prezantohet pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Të prezantohet pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Të prezantohet pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Të prezantohet pëlqimi nga “Ekoregjioni”.
- Të prezantohet aktvendimi nga Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë
- Të prezantohet Leja Mjedisore Komunale
- Të prezantohet pëlqimi nga Drejtoria e Shërbimeve publike(Sektori i komunikacionit).
- Të prezantohet pëlqimi nga Kompania Rajonale e Ujitjes – “Dukagjini
- Të punohet projekti kryesor.

Dokumentacioni teknik duhet të hartohet, nga një firmë projektuese, i njeiti duhet të dorëzohet në tri kopje identike dhe një kopje në formë elektronike në formë DWG ose PDF dhe duhet të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës në kuadër të zonës.
- Situacionin e gjerë në diametër prej 50m, me objektet ekzistuese dhe objektin e planifikuar.
- Situatën e terrenit me izohipsa në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000.
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave në përpjesë 1:50.
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogarit të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare.
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50.



- Detajet e rrethojës.
- Llogarinë statike-përshkrimi teknik, pozicionimi dhe detaje.
- Projektet e instalimeve (elektrike, ujësjellës, kanalizim, etj.).

./..

P. S. Me këtë Njoftim për plotësim të dokumentacionit investitori nuk ka të drejtë të filloj punimeve në teren.

ARSYETIM

Parashtruesi kërkesës **Gjeladin Shala** me banim në rrugën “Jeta e Re” nr.9/A pranë shërbimit të DUPH-së ka kërkuar leje për ndërtimin e objektit-Shtallë e kuajve me etazhitet P+1 në ngastrat katastrale numër **P-71813041-00988-24 dhe P-71813041-00988-2** Z. K. Landovicë .

Andaj procedurat në vazhdim e obligojnë palën ta prezantoj pranë shërbimit të DUPH-së dokumentacionin e kërkuar ta sigurojnë me qëllim të vazhimit të procedurave,në të kundërtën kërkesa e juaj do të refuzohet.

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij Njoftimi pala e pakënaqur ka të drejtë kundërshtimi në afatin prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit në Drejtorin për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor-Komuna e Prizrenit.

Bashkëpunëtori Profesional:



Xhejlane Gjini, Inxh. Dip. Ark.

